(2) Amendamente mund të paraqesin grupi i deputetëve, secili (një) deputet dhe propozuesi, më së voni në afat prej tri ditësh pune para ditës së caktuar për mbajtjen e seancës së Kuvendit.

(3) Nëse Propozimligji propozohet të miratohet me procedurë të shkurtuar, amendament mund të paraqitet deri në fillim të seancës për Leximin e dytë të Propozimligjit.

(4) Me përjashtim, amendament mund të paraqitet deri në përfundimin e diskutimit të Propozimligjit, nëse me të bëhet harmonizimi i dispozitave të tekstit, të cilat janë ndryshuar për

претходно усвојување на еден или повеќе амандмани.

(5) Кога законот се носи по итна постапка амандман може да се поднесе до завршување на претресот.

(6) Поднесувањето и гласањето по амандманите на седница на Собранието се врши согласно со членовите 158, 160 и 161, доколку со овој деловник поинаку не е определено.

(7) Само подносителот на амандманот може да даде образложение и да говори по амандманот во времетраење од вкупно три минути.

(8) Доколку подносители на амандман се двајца или повеќе пратеници само еден од подносителите може да даде образложение и да говори по амандманот во времетраење од вкупно три минути.

**Член 164**

(1) Амандманот се усвојува со мнозинство гласови од присутните пратеници, а најмалку со една третина од вкупниот број пратеници, без оглед на мнозинството гласови потребно за донесување на законот, утврдено со Уставот.

(2) Амандманот на подносителот на предлог на законот и амандманот со кој тој се согласил се смета за составен дел на предлогот на законот.

**Член 165**

(1) Ако се усвоени амандмани на повеќе од една третина од членовите на дополнетиот предлог на закон, по завршеното второ читање се подготвува и правно-технички се уредува текстот на законот за трето читање.

(2) Ако предлогот на закон е поднесен од Владата, Собранието може во случајот од ставот (1) на овој член, да одлучи Владата да го изготви текстот на предлогот на закон за третото читање.

(3) Ако матичното работно тело и Законодавно-правната комисија констатираат дека одделни одредби од предлогот на закон при усвојување на амандманите во второто читање меѓу себе се неусогласени или не се во согласност со Уставот или со други закони, за тоа го известуваат Собранието и предлагаат можни решенија.

**Член 166**

(1) Ако на второто читање на седница на Собранието се усвоени амандмани на помалку од една третина од членовите на изменетиот предлог на закон, Собранието може да одлучи

shkak të miratimit paraprak të një apo më shumë amendamenteve.

(5) Kur ligji miratohet me procedurë urgjente, amendament mund të paraqitet deri në përfundim të diskutimit.

(6) Paraqitja dhe votimi për amendamentet në seancën e Kuvendit, bëhet në përputhje me nenet 158, 160 dhe 161, nëse me këtë Rregullore nuk është përcaktuar ndryshe.

(7) Vetëm paraqitësi i amendamentit mund të japë arsyetim dhe të flasë për amendamentin në kohëzgjatje prej gjithsej tre minutash.

(8) Nëse paraqitës të amendamentit janë dy ose më shumë deputetë, vetëm njëri nga paraqitësit mund të japë arsyetim dhe të flasë për amendamentin në kohëzgjatje prej gjithsej tre minutash.

**Neni 164**

(1) Amendamenti miratohet me shumicë votash të deputetëve të pranishëm dhe të paktën me një të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, pavarësisht nga shumica e votave të nevojshme për miratimin e ligjit, e përcaktuar me Kushtetutë.

(2) Amendamenti i paraqitësit të Propozimligjit dhe amendamenti me të cilin ai është pajtuar, konsiderohet si pjesë përbërëse e Propozimligjit.

**Neni 165**

(1) Nëse janë miratuar amendamente të më shumë se një të tretës së neneve të Propozimligjit të plotësuar, pas mbarimit të Leximit të dytë, përgatitet dhe në mënyrë juridiko-teknike rregullohet teksti i Ligjit, për Lexim të tretë.

(2) Nëse Propozimligji është paraqitur nga Qeveria, Kuvendi, në rastin e paragrafit (1) të këtij neni, mund të vendosë që Qeveria ta hartojë tekstin e Propozimligjit për Lexim të tretë.

(3) Nëse Trupi punues amë dhe Komisioni Juridik Ligjvënës konstatojnë se dispozita të caktuara të Propozimligjit, gjatë miratimit të amendamenteve në Leximin e dytë, nuk janë të harmonizuara ndërmjet tyre ose nuk janë në përputhje me Kushtetutën apo me ligje të tjera, për këtë e njoftojnë Kuvendin dhe propozojnë zgjidhje të mundshme.

**Neni 166**

(1) Nëse në Lexim të dytë në seancën e Kuvendit janë miratuar amendamente të më pak se

третото читање на предлогот на закон да се одржи на истата седница.

(2) Претседавачот одлучува дали третото читање ќе се одржи веднаш по усвојувањето на одлуката од ставот (1) на овој член.

**Член 167**

Ако Собранието во текот на второто читање не усвои ниту еден амандман на дополнетиот предлог на закон, се преминува на гласање по предлогот на законот на истата седница.

**6. Трето читање**

**6.1. Разгледување на предлог на закон на седница на Собрание**

**Член 168**

Третото читање на предлогот на закон по правило се одржува на првата наредна седница по второто читање на седницата на Собранието. Во оваа фаза работните тела не расправаат.

**Член 169**

(1) Во текот на третото читање Собранието расправа и одлучува само по членовите на дополнетиот предлог на закон за кои се поднесени амандмани и одлучува за предлогот на закон во целина.

(2) Во текот на третото читање на предлог на закон, амандмани можат да се поднесат само на членовите на кои биле усвоени амандмани во текот на второто читање на седницата на Собранието.

(3) Амандман може да поднесе предлагачот и пратеник, најдоцна во рок од два работни дена пред денот определен за одржување на седница на Собрание.

(4) Претресот по амандманите се одвива согласно со членот 160 од овој деловник.

**7. Гласање и изјаснување на седница на Собрание**

**Член 170**

(1) Претседателот на Собранието може расправата по предлогот на закон, амандманите и другите акти од надлежност на Собранието да ја заврши, а за гласањето по истите да определи ден и час кога Собранието ќе се изјасни.

(2) Собранието се изјаснува по предлогот на законот, амандманите и другите акти од надлежност на Собранието без расправа.

një të tretës së neneve të Propozimligjit të ndryshuar, Kuvendi mund të vendosë që Leximi i tretë i Propozimligjit të mbahet në seancën e njëjtë.

(2) Kryesuesi vendos, nëse Leximi i tretë do të mbahet menjëherë pas miratimit të vendimit të paragrafit (1) të këtij neni.

**Neni 167**

Nëse Kuvendi gjatë Leximit të dytë nuk e miraton asnjë amendament të Propozimligjit të plotësuar, kalohet në votim për Propozimligjin në të njëjtën seancë.

**6. Leximi i tretë**

**6.1. Shqyrtimi i propozimligjit në seancën e Kuvendit**

**Neni 168**

Leximi i tretë i Propozimligjit sipas rregullit mbahet në seancën e parë të radhës, pas Leximit të dytë në seancë të Kuvendit. Në këtë fazë trupat punues nuk diskutojnë.

**Neni 169**

(1) Gjatë Leximit të tretë, Kuvendi diskuton dhe vendos vetëm për nenet e Propozimligjit të plotësuar, për të cilat janë paraqitur amendamente dhe vendos për Propozimligjin në tërësi.

(2) Gjatë Leximit të tretë të propozimligjit, amendamente mund të paraqiten vetëm për nenet për të cilat janë miratuar amendamente gjatë Leximit të dytë në seancë të Kuvendit.

(3) Amendament mund të paraqesë propozuesi dhe deputeti, më së voni në afat prej dy ditësh pune, para ditës së caktuar për mbajtjen e seancës së Kuvendit.

(4) Diskutimi për amendamentet zhvillohet në përputhje me nenin 160 të kësaj Rregulloreje.

**7. Votimi dhe deklarimi në seancën e Kuvendit**

**Neni 170**

(1) Kryetari i Kuvendit mund ta përfundojë diskutimin për Propozimligjin, amendamentet dhe aktet e tjera në kompetencë të Kuvendit, ndërsa për votimin e të njëjtëve do ta caktojë ditën dhe orën kur do të deklarohet Kuvendi.

(2) Kuvendi deklarohet për Propozimligjin, amendamentet dhe aktet e tjera në kompetencë të Kuvendit, pa diskutim.

**8. Мнозинство потребно за донесување на закон**

**Член 171**

Законите се донесуваат со мнозинството гласови на пратениците утврдено во Уставот и во закон.

**9. Итна постапка за донесување на закон**

**Член 172**

(1) По исклучок закон може да се донесе и по итна постапка.

(2) По итна постапка може да се донесе закон кога тоа е неопходно заради спречување и отстранување на големи нарушувања во стопанството или кога тоа го бараат интересите на безбедноста и одбраната на Републиката или при големи природни непогоди, епидемии или други вонредни и неодложни случаи.

(3) Предлогот, законот да се донесе по итна постапка, предлагачот е должен да го образложи.

(4) Кон предлогот, законот да се донесе по итна постапка се поднесува и предлогот на законот чие донесување се предлага.

**Член 173**

(1) За оправданоста на предлогот, законот да се донесе по итна постапка, одлучува Собранието без претрес.

(2) Ако Собранието одлучи да расправа по предлогот, законот да се донесе по итна постапка, ги задолжува матичното работно тело и Законодавно-правната комисија да расправаат по предлогот на закон.

(3) Седницата на матичното работно тело и на Законодавно-правната комисија се свикува и започнува веднаш, но не подоцна од 24 часа од задолжувањето од ставот (2) на овој член.

(4) Седницата од ставот (3) на овој член ќе заврши во рок од 24 часа од започнувањето.

**Член 174**

(1) Кога предлогот на закон се разгледува по итна постапка, не се одржува општ претрес. Второто и третото читање се одржуваат на иста седница. Во тој случај второто читање започнува со претрес по предлогот на законот согласно со одредбите од овој деловник за второто читање.

(2)Собранието по предлогот на претседателот на Собранието, координатор на пратеничка група или еден пратеник чие барање го поддржуваат најмалку 10 пратеници, може да побара од матичното работно тело и

**8. Shumica e nevojshme për miratim të ligjit**

**Neni 171**

Ligjet miratohen me shumicën e votave të deputetëve, të përcaktuar në Kushtetutë dhe në Ligj.

**9. Procedura urgjente e miratimit të ligjit**

**Neni 172**

(1) Me përjashtim, ligji mund të miratohet edhe me procedurë urgjente.

(2) Me procedurë urgjente mund të miratohet ligji kur kjo është e domosdoshme për parandalimin dhe eliminimin e çrregullimeve të mëdha në ekonomi ose kur këtë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe të mbrojtjes së Republikës, ose në rast të fatkeqësive të mëdha natyrore, të epidemive apo në raste të tjera të jashtëzakonshme dhe të paprolongueshme.

(3) Propozimin që ligji të miratohet me procedurë urgjente, propozuesi është i detyruar ta arsyetojë.

(4) Me propozimin që ligji të miratohet me procedurë urgjente paraqitet edhe Propozimligji, miratimi i të cilit propozohet.

**Neni 173**

(1) Për arsyeshmërinë e propozimit, që ligji të miratohet me procedurë urgjente, vendos Kuvendi pa diskutim.

(2) Nëse Kuvendi vendos të diskutojë për propozimin që ligji të miratohet me procedurë urgjente, i ngarkon Trupin punues amë dhe Komisionin Juridik Ligjvënës ta shqyrtojnë Propozimligjin.

(3) Mbledhja e Trupit punues amë dhe e Komisionit Juridik Ligjvënës thirret dhe fillon menjëherë, por jo më vonë se 24 orë pas ngarkimit të paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Mbledhja e paragrafit (3) të këtij neni do të përfundojë në afat prej 24 orësh nga fillimi i saj.

**Neni 174**

(1) Kur propozimligji shqyrtohet me procedurë urgjente, diskutimi i përgjithshëm nuk mbahet. Leximi i dytë dhe i tretë mbahen në seancën e njëjtë. Në atë rast Leximi i dytë fillon me diskutim për propozimligjin në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje për Lexim të dytë.

(2) Kuvendi, me propozim të Kryetarit të Kuvendit, koordinatorit të grupit të deputetëve apo të një deputeti, kërkesën e të cilit e mbështesin të paktën 10 deputetë, mund të kërkojë nga Trupi

Законодавно-правната комисија да се изјаснат по амандманите поднесени по завршувањето на нивните седници.

**10. Скратена постапка за донесување на закон**

**Член 175**

Предлагачот на предлогот на закон може да му предложи на Собранието да расправа по предлогот на закон по скратена постапка во случај кога:

- не е во прашање сложен и обемен закон,
- престанок на важноста на некој закон или одделни одредби од некој закон или
- не се во прашање сложени или обемни усогласувања на законот со правото на Европската Унија.

**Член 176**

(1) Ако Собранието одлучи да расправа, предлогот на закон да се донесе по скратена постапка, претседателот на Собранието веднаш го задолжува матичното работно тело и Законодавно-правната комисија да расправаат по предлогот на закон.

(2) Седницата на матичното работно тело и на Законодавно-правната комисија се свикува и започнува веднаш, но не подоцна од 24 часа од задолжувањето од ставот (1) на овој член, ниту порано од шест часа од задолжувањето од ставот (1) на овој член, а ќе заврши во рок од три дена од започнувањето.

(3) Одредбата од ставот (2) на овој член нема да се применува на Изборниот законик, Деловникот на Собранието на Република Северна Македонија, Законот за Собранието на Република Северна Македонија, Законот за пратениците и Законот за финансирање на политичките партии.

(4) Кога предлогот на закон се разгледува по скратена постапка Собранието одржува општ претрес.

(5) Второто и третото читање се одржуваат на иста седница. Во тој случај второто читање започнува со претрес по предлогот на законот во согласност со одредбите од овој деловник за второ читање. Амандмани можат да се поднесат на седницата до почетокот на третото читање на предлогот на законот.

**11. Разгледување на седница на работно тело на предлог на закон од надлежност на матичното работно тело за финансиите и буџетот, предлог на закон од надлежност на**

punues amë dhe nga Komisioni Juridik Ligjvënës që të deklarohen për amendamentet e parashtruara pas përfundimit të mbledhjeve të tyre.

**10. Procedura e shkurtuar për miratimin e ligjit**

**Neni 175**

Propozuesi i propozimligjit mund t'i propozojë Kuvendit të diskutojë për propozimligjin me procedurë të shkurtuar kur:

- nuk bëhet fjalë për ligj të ndërlikuar dhe të vëllimshëm,
- bëhet shfuqizimi i ndonjë ligji apo të dispozitave të caktuara të ndonjë ligji ose
- nuk bëhet fjalë për harmonizime komplekse dhe vëllimore të ligjit me të drejtën e Bashkimit Europian.

**Neni 176**

(1) Nëse Kuvendi vendos të diskutojë, që propozimligji të miratohet me procedurë të shkurtuar, Kryetari i Kuvendit menjëherë e ngarkon Trupin punues amë dhe Komisionin Juridik Ligjvënës që ta shqyrtojnë propozimligjin.

(2) Mbledhja e Trupit punues amë dhe e Komisionit Juridik Ligjvënës thirret dhe fillon menjëherë, por jo më vonë se 24 orë pas ngarkimit të paragrafit (1) të këtij neni, as më herët se gjashtë orë pas ngarkimit të paragrafit (1) të këtij neni, ndërsa do të përfundojë në afat prej tri ditësh nga fillimi.

(3) Dispozita e paragrafit (2) të këtij neni, nuk do të zbatohet për Kodin zgjedhor, Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjin e Deputetëve dhe Ligjin e Financimit të Partive Politike.

(4) Kur propozimligji shqyrtohet me procedurë të shkurtuar, Kuvendi mban diskutim të përgjithshëm.

(5) Leximi i dytë dhe i tretë mbahen në të njëjtën seancë. Në këtë rast Leximi i dytë fillon me shqyrtimin e propozimligjit në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje për Leximin e dytë. Amendamente mund të parashtrohen në seancë deri në fillimin e Leximit të tretë të propozimligjit.

**11. Shqyrtimi në mbledhje të Trupit punues të propozimligjit në kompetencë të Trupit punues amë për financa dhe buxhet, i propozimligjit në kompetencë të Trupit punues amë për çështje**

**матичното работно тело за економските прашања и на предлог на закон со кој се врши усогласување со правото на Европската Унија**

**Член 177**

(1) Општиот претрес по предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за финансиите и буџетот, по предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за економските прашања и по предлогот на закон со кој се врши усогласување со правото на Европската Унија, во матичното работно тело и во Законодавно-правната комисија може да трае најмногу три работни дена.

(2) Член на работното тело и пратеник во текот на општиот претрес може да говорат повеќе пати во траење од вкупно 20 минути, а координатор на пратеничка група вкупно 30 минути.

(3) Предлагачот и претставникот на Владата, кога Владата не е предлагач, може да говорат повеќе пати, но не повеќе од 15 минути вкупно.

(4) Доколку подносители на предлогот на закон се двајца или повеќе пратеници само еден од подносителите може да даде образложение и да говори по предлог на законот во времетраење од вкупно 15 минути.

**Член 178**

Одредбите од овој деловник што се однесуваат на постапката за разгледување на предлогот на закон во работните тела во прво читање соодветно се применуваат и при општиот претрес на предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за финансиите и буџетот, предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за економските прашања и по предлогот на закон со кој се врши усогласување со правото на Европската Унија.

**Член 179**

(1) Второто читање по предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за финансиите и буџетот, по предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за економските прашања и по предлог на закон со кој се врши усогласување со правото на Европската Унија во матичното работно тело и во Законодавно-правната комисија може да трае најмногу три работни дена.

(2) Член на работното тело и пратеник во текот на претресот по амандман може да говорат само еднаш во траење од 10 минути.

**ekonomike dhe i propozimligjit me të cilin bëhet harmonizimi me të drejtën e Bashkimit Europian**

**Neni 177**

(1) Diskutimi i përgjithshëm për propozimligj në kompetencë të Trupit punues amë për financa dhe buxhet, për propozimligj në kompetencë të Trupit punues amë për çështje ekonomike dhe për propozimligj me të cilin bëhet harmonizimi me të drejtën e Bashkimit Europian, në Trupin punues amë dhe në Komisionin Juridik Ligjvënës, mund të zgjasë deri tri ditë pune.

(2) Anëtari i Trupit punues dhe deputeti, gjatë diskutimit të përgjithshëm, mund të flasin më shumë herë në kohëzgjatje prej gjithsej 20 minutash, ndërsa koordinatori i grupit të deputetëve gjithsej 30 minuta.

(3) Propozuesi dhe përfaqësuesi i Qeverisë, kur Qeveria nuk është propozues, mund të flasin më shumë herë por jo më shumë se 15 minuta gjithsej.

(4) Nëse parashtrues të propozimligjit janë dy apo më shumë deputetë vetëm njëri prej parashtruesve mund të japë arsyetim dhe të flasë për propozimligjin në kohëzgjatje prej gjithsej 15 minutash.

**Neni 178**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje që kanë të bëjnë me procedurën për shqyrtimin e propozimligjit në Trupat punues në Lexim të parë, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe gjatë diskutimit të përgjithshëm për propozimligj në kompetencë të Trupit punues amë për Financa dhe Buxhet, për propozimligj në kompetencë të Trupit punues amë për Çështje Ekonomike dhe për propozimligj me të cilin bëhet harmonizimi me të drejtën e Bashkimit Europian.

**Neni 179**

(1) Leximi i dytë, për propozimligj në kompetencë të Trupit punues amë për Financa dhe Buxhet, për propozimligj në kompetencë të Trupit punues amë për Çështje Ekonomike dhe për propozimligj me të cilin bëhet harmonizimi me të drejtën e Bashkimit Europian, në Trupin punues amë dhe në Komisionin Juridik Ligjvënës, mund të zgjasë më së shumti tri ditë pune.

(2) Anëtari i Trupit punues dhe deputeti, gjatë diskutimit për amendamentin, mund të flasin vetëm një herë në kohëzgjatje prej 10 minutash. Koordinatori i grupit të deputetëve apo një deputet i

Координатор на пратеничката група или еден пратеник определен од пратеничката група или од координаторот на пратеничката група во претрес по амандман може да говори само еднаш во траење од 15 минути.

(3) Само подносителот на амандманот може да даде образложение и да говори по амандманот во времетраење од вкупно 10 минути, а доколку подносители на амандман се двајца или повеќе пратеници само еден од подносителите може да даде образложение и да говори по амандманот во времетраење од вкупно 10 минути.

caktuar nga grupi i deputetëve ose nga koordinatori i grupit të deputetëve, gjatë diskutimit për amendamentin mund të flasë vetëm një herë në kohëzgjatje prej 15 minutash.

(3) Vetëm parashtruesi i amendamentit mund të japë arsyetim dhe të flasë për amendamentin, në kohëzgjatje prej gjithsej 10 minutash, e nëse parashtrues të amendamentit janë dy apo më shumë deputetë, vetëm njëri prej parashtruesve mund të japë arsyetim dhe të flasë për amendamentin në kohëzgjatje prej gjithsej 10 minutash.

**Член 180**

Одредбите од овој деловник што се однесуваат на постапката за разгледување на предлог на закон во работните тела во второ читање соодветно се применуваат и при второто читање на предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за финансиите и буџетот, предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за економските прашања и по предлогот на закон со кој се врши усогласување со правото на Европската Унија.

**Neni 180**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje që kanë të bëjnë me procedurën për shqyrtimin e propozimligjit në trupat punues në Lexim të dytë, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe gjatë Leximit të dytë të propozimligjit në kompetencë të Trupit punues amë për Financa dhe Buxhet, të propozimligjit në kompetencë të Trupit punues amë për Çështje Ekonomike dhe të propozimligjit me të cilin bëhet harmonizimi me të drejtën e Bashkimit Europian.

**Член 181**

(1) Расправата во матичното работно тело и во Законодавно-правната комисија по предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за финансиите и буџетот, по предлогот на закон од надлежност на матичното работно тело за економските прашања и по предлогот на закон со кој се врши усогласување со правото на Европската Унија, кои се разгледуваат по скратена или итна постапка, може да трае најмногу два работни дена.

(2) Член на работното тело и пратеник во текот на претресот по амандман може да говори само еднаш во траење од 10 минути. Координатор на пратеничката група или еден пратеник определен од пратеничката група или од координаторот на пратеничката група во претрес по амандман, може да говори само еднаш во траење од 15 минути.

(3) Само подносителот на амандманот може да даде образложение и да говори по амандманот во времетраење од вкупно 10 минути, а доколку подносители на амандман се двајца или повеќе пратеници само еден од подносителите може да даде образложение и да говори по амандманот во времетраење од вкупно 10 минути.

**Neni 181**

(1) Diskutimi në Trupin punues amë dhe në Komisionin Juridik Ligjvënës, për propozimligjin në kompetencë të Trupit punues amë për Financa dhe Buxhet, për propozimligjin në kompetencë të Trupit punues amë për Çështje Ekonomike dhe për propozimligjin me të cilin bëhet harmonizimi me të drejtën e Bashkimit Europian, të cilat shqyrtohen me procedurë të shkurtuar apo urgjente, mund të zgjasë më së shumti dy ditë pune.

(2) Anëtari i Trupit punues dhe deputeti, gjatë diskutimit për amendamentin, mund të flasë vetëm një herë në kohëzgjatje prej 10 minutash. Koordinatori i grupit të deputetëve apo një deputet i caktuar nga grupi i deputetëve ose nga koordinatori i grupit të deputetëve, gjatë diskutimit për amendamentin, mund të flasë vetëm një herë në kohëzgjatje prej 15 minutash.

(3) Vetëm paraqitësi i amendamentit mund të japë arsyetim dhe të flasë për amendamentin në kohëzgjatje prej gjithsej 10 minutash, ndërsa nëse paraqitës të amendamentit janë dy apo më shumë deputetë, vetëm njëri prej paraqitësve mund të japë arsyetim dhe të flasë për amendamentin në kohëzgjatje prej gjithsej 10 minutash.

## 12. Потпишување и објавување на актите

**Член 182**

(1) Текстот на законот не се потпишува.

(2) Другите прописи и општи акти што ги донесува Собранието, ги потпишува претседателот на Собранието.

(3) Актите што самостојно ги донесуваат работните тела ги потпишува претседателот на телото што го донело актот.

**Член 183**

(1) Претседателот на Собранието, веднаш по донесувањето, законот го доставува до претседателот на Републиката заради потпишување на указот за прогласување на законот.

(2) Ако претседателот на Републиката одлучи да не го потпише указот за прогласување на законот, Собранието повторно го разгледува законот во фаза на трето читање, во рок од 30 дена од денот на донесувањето на законот.

(3) По повторното разгледување на законот, амандмани можат да се поднесуваат само во врска со укажувањето на претседателот на Републиката.

**Член 184**

(1) Законите, другите прописи и општи акти пред да влезат во сила, се објавуваат во „Службен весник на Република Северна Македонија”.

(2) Заклучоците на Собранието се објавуваат во гласилото на Собранието, а ако Собранието одлучи и во „Службен весник на Република Северна Македонија”.

(3) Заклучоците на работните тела, ако тие одлучат, се објавуваат на веб-страницата на Собранието.

## 13. Автентично толкување на закон

**Член 185**

Барање за давање на автентично толкување на закон може да поднесе секој пратеник, Владата, Уставниот суд на Република Северна Македонија, Врховниот суд на Република Северна Македонија, Јавниот обвинител на Република Северна Македонија, народниот правобранител, градоначалниците на општините и на градот Скопје и советите на општините и на градот Скопје, доколку потребата од автентично толкување настанала во врска со примена на законите во нивното работење.

## 12. Nënshkrimi dhe shpallja e akteve

**Neni 182**

(1) Teksti i ligjit nuk nënshkruhet.

(2) Normat e tjera dhe aktet e përgjithshme që i miraton Kuvendi, i nënshkruan Kryetari i Kuvendit.

(3) Aktet që i miratojnë trupat punues në mënyrë të pavarur, i nënshkruan kryetari i Trupit që e ka miratuar aktin.

**Neni 183**

(1) Kryetari i Kuvendit, menjëherë pas miratimit, ligjin ia dërgon Presidentit të Republikës, për nënshkrimin e dekretit për shpalljen e ligjit.

(2) Nëse Presidenti i Republikës vendos të mos e nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjit, Kuvendi e rishqyrton ligjin në fazën e Leximit të tretë, në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të ligjit.

(3) Gjatë rishqyrtimit të ligjit, amendamente mund të parashtrohen vetëm në lidhje me sugjerimin e Presidentit të Republikës.

**Neni 184**

(1) Ligjet, normat e tjera dhe aktet e përgjithshme, para se të hyjnë në fuqi botohen në ,,Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

(2) Konkluzionet e Kuvendit, shpallen në buletinin e Kuvendit, e nëse vendos Kuvendi, edhe në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

(3) Konkluzionet e trupave punues, nëse ato vendosin, shpallen në ueb faqen e Kuvendit.

## 13. Interpretimi autentik i ligjit

**Neni 185**

Kërkesë për dhënien e interpretimit autentik të ligjit mund të parashtrojë çdo deputet, Qeveria, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Avokati i Popullit, kryetarët e komunave dhe kryetari i Qytetit të Shkupit dhe Këshillat e Komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit, nëse nevoja për interpretim autentik është paraqitur në lidhje me zbatimin e ligjeve në punën e tyre.

**Член 186**

(1) Барањето за давање на автентично толкување на закон се поднесува до претседателот на Собранието и содржи наслов на законот, одредби на кои се бара толкување и причините за тоа.

(2) Барањето за давање на автентично толкување на закон, претседателот на Собранието го упатува до Законодавно-правната комисија и до Владата.

(3) По барањето за давање на автентично толкување на закон, Законодавно-правната комисија може да бара мислење од матичното работно тело на Собранието.

(4) Законодавно-правната комисија, откако ќе прибави мислења од Владата и од матичното работно тело, оценува дали барањето за давање на автентично толкување е оправдано.

(5) Ако Законодавно-правната комисија оцени дека барањето за давање на автентично толкување е оправдано, изготвува предлог на автентично толкување и го доставува до Собранието.

(6) По предлогот за автентично толкување на закон и по поднесени амандмани, Собранието расправа и одлучува на иста седница. Амандмани по предлогот за автентично толкување на закон се поднесуваат до почетокот на седницата на Собранието.

(7) Предлогот на автентичното толкување се усвојува со истото мнозинство со кое се донесува законот на кој се дава автентичното толкување.

(8) Автентичното толкување се објавува во „Службен весник на Република Северна Македонија".

(9) Ако Законодавно-правната комисија оцени дека барањето за давање на автентично толкување не е оправдано, ќе поднесе извештај на Собранието, кое одлучува по барањето. За одлуката на Собранието се известува подносителот на барањето.

**14. Постапка за утврдување пречистен текст на закон**

**Член 187**

(1) Ако законот е повеќе пати изменуван или дополнуван или ако со законот се вршат пообемни изменувања и дополнувања, предлагачот на законот може да предложи да се утврди пречистен текст на законот.

(2) Ако оцени дека тоа е оправдано, Собранието со законот од ставот (1) на овој член

**Neni 186**

(1) Kërkesa për dhënien e interpretimit autentik të ligjit i paraqitet Kryetarit të Kuvendit dhe përmban titullin e ligjit, dispozitat për të cilat kërkohet interpretimi dhe arsyet për atë.

(2) Kërkesën për dhënien e interpretimit autentik të ligjit, Kryetari i Kuvendit ia kalon Komisionit Juridik Ligjvënës dhe Qeverisë.

(3) Për kërkesën e dhënies së interpretimit autentik të ligjit, Komisioni Juridik- Ligjvënës mund të kërkojë mendim nga Trupi punues amë i Kuvendit.

(4) Komisioni Juridik Ligjvënës pasi t'i marrë mendimet e Qeverisë dhe të Trupit punues amë, jep vlerësimin nëse kërkesa për dhënien e interpretimit autentik është e arsyeshme.

(5) Nëse Komisioni Juridik Ligjvënës vlerëson se kërkesa për dhënien e interpretimit autentik është e arsyeshme, harton propozim për interpretim autentik dhe ia paraqet Kuvendit.

(6) Për propozimin e interpretimit autentik të ligjit dhe për amendamentet e paraqitura, Kuvendi diskuton dhe vendos në seancën e njëjtë. Amendamente për propozimin e interpretimit autentik të ligjit paraqiten deri në fillim të seancës së Kuvendit.

(7) Propozimi për interpretim autentik, miratohet me shumicën e njëjtë me të cilën miratohet ligji, të cilit i bëhet interpretimi autentik.

(8) Interpretimi autentik botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(9) Nëse Komisioni Juridik Ligjvënës vlerëson se kërkesa për dhënien e interpretimit autentik nuk është e arsyeshme, do t'i paraqesë raport Kuvendit, i cili vendos për kërkesën. Për vendimin e Kuvendit njoftohet parashtruesi i kërkesës.

**14. Procedura për përcaktimin e tekstit të konsoliduar të ligjit**

**Neni 187**

(1) Nëse ligji është më shumë herë i ndryshuar ose i plotësuar, apo nëse me ligjin bëhen ndryshime dhe plotësime më të vëllimshme, propozuesi i ligjit mund të propozojë që të përcaktohet teksti i konsoliduar i ligjit.

(2) Nëse vlerëson se kjo është e arsyeshme, Kuvendi, me ligjin e paragrafit (1) të këtij neni, do ta

ќе ја овласти Законодавно-правната комисија да утврди пречистен текст на законот и да го објави во „Службен весник на Република Северна Македонија" во рок од 30 дена од денот на објавувањето на законот за изменување и дополнување на законот во „Службен весник на Република Северна Македонија".

(3) Пречистениот текст на законот го изготвува предлагачот на законот и на Законодавно-правната комисија и го поднесува за утврдување во рок од 15 дена од денот на објавувањето на законот за изменување и дополнување на законот во „Службен весник на Република Северна Македонија".

(4) Собранието, преку Законодавно-правната комисија, задолжително изготвува пречистен текст на закон, кој е менуван или дополнуван повеќе од трипати.

### 15. Постапка по предлози на закони по истекот на мандатот на составот на Собранието

**Член 188**

(1) Со истекот на мандатот на составот на Собранието завршуваат сите законодавни постапки и постапки за донесување на други акти започнати во мандатниот период.

(2) По исклучок, продолжува законодавната постапка започната на предлог на 10.000 избирачи, на Владата доколку во рок од 30 дена од нејзиниот избор Владата извести дека тоа е потребно, како и постапките започнати на предлог на пратениците од претходниот состав, а пратениците го презеле во рок од 30 дена од конституирањето на Собранието.

### 16. Постапка за донесување на Буџет и Завршна сметка на Буџетот

#### 16.1 Постапка за донесување на Буџет

**Член 189**

(1) Предлогот на буџетот на Република Северна Македонија (во натамошниот текст: предлог на буџетот) со потребната документација согласно со закон, Владата го поднесува до претседателот на Собранието во рокот утврден со закон.

(2) Општиот претрес и претресот по амандманите во матичното работно тело завршува најдоцна до крајот на месец ноември.

(3) Планот за начинот и времетраењето на расправата по предлогот на буџетот го подготвува претседателот на Собранието, по

autorizojë Komisionin Juridik Ligjvënës ta përcaktojë tekstin e konsoliduar të ligjit dhe ta botojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në afat prej 30 ditësh nga dita e botimit të ligjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(3) Tekstin e konsoliduar të ligjit e harton propozuesi i ligjit dhe ia paraqet Komisionit Juridik Ligjvënës për verifikim, në afat prej 15 ditësh nga dita e botimit të ligjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(4) Kuvendi, nëpërmjet Komisionit Juridik Ligjvënës, detyrimisht harton tekst të konsoliduar të ligjit, i cili është ndryshuar ose plotësuar më shumë se tri herë.

### 15. Procedura për propozimligje pas përfundimit të mandatit të legjislaturës së Kuvendit

**Neni 188**

(1) Me përfundimin e mandatit të legjislaturës së Kuvendit, përfundojnë të gjitha procedurat ligjvënëse dhe procedurat e miratimit të akteve të tjera të filluara në periudhën e mandatit.

(2) Me përjashtim, vazhdon procedura ligjvënëse e filluar me propozimin e 10.000 zgjedhësve, e Qeverisë, nëse në afat prej 30 ditësh nga zgjedhja e saj, Qeveria njofton se kjo është e nevojshme, si dhe procedurat e filluara me propozim të deputetëve të legjislaturës së mëparshme, ndërsa deputetët e kanë marrë në afat prej 30 ditësh nga konstituimi i Kuvendit.

### 16. Procedura për miratimin e Buxhetit dhe të Llogarisë përfundimtare të Buxhetit

#### 16.1 Procedura për miratimin e Buxhetit

**Neni 189**

(1) Propozimbuxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejmë: propozimbuxheti) me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me ligjin, Qeveria ia dërgon Kryetarit të Kuvendit në afatin e përcaktuar me ligj.

(2) Diskutimi i përgjithshëm dhe diskutimi për amandamentet në Trupin punues amë përfundon më së voni deri në fund të muajit nëntor.

(3) Plani për mënyrën dhe kohëzgjatjen e diskutimit për Propozimbuxhetin përgatitet nga Kryetari i Kuvendit pas konsultimit paraprak me

претходна консултација со претседателот на матичното работно тело. Планот подготвен од претседателот на Собранието се усогласува на посебна координација.

(4) За седницата на матичното работно тело се обезбедува директен пренос преку Собранискиот канал.

(5) Законодавно-правната комисија не го разгледува предлогот на буџетот.

(6) Во постапката за разгледување на предлогот на буџетот во матичното работно тело пратеникот има право на две реплики во траење од по три минути и две контра реплики во траење од по една минута, а за неправилна примена на Деловникот соодветно се применува членот 94 став (5) од овој деловник.

**Член 190**

(1) По предлог на буџетот матичното работно тело одржува општ претрес, кој трае најмногу четири дена.

(2) Образложение на предлогот на буџетот дава претставникот на Владата, во траење од 30 минути.

(3) Пратеник во општиот претрес може да говори повеќе пати во траење од вкупно 20 минути, а координатор на пратеничка група вкупно 30 минути. Претставникот на Владата во општиот претрес може да говори повеќе пати, но не повеќе од 30 минути вкупно.

**Член 191**

(1) Амандман на предлогот на буџетот може да се поднесе најдоцна три работни дена пред денот определен за одржување на седницата на матичното работно тело. За поднесувањето на амандманите соодветно се применува членот 157 од овој деловник.

(2) Претресот по амандманите се води во матичното работно тело и трае најмногу шест дена.

(3) Пратеник во претрес по амандман може да говори само еднаш во траење од 10 минути. Претставникот на Владата за прифатливоста на амандман може да говори само еднаш во траење од пет минути.

(4) Подносителот на амандманот може да даде образложение и да говори по амандманот само еднаш во траење од 15 минути, а доколку подносители на амандман се двајца или повеќе пратеници само еден од подносителите може да даде образложение и да говори по амандманот само еднаш во траење од 15 минути.

kryetarin e Trupit punues amë. Plani i përgatitur nga Kryetari i Kuvendit harmonizohet në koordinim të veçantë.

(4) Për mbledhjen e Trupit punues amë sigurohet transmetim i drejtpërdrejtë përmes Kanalit të Kuvendit.

(5) Komisioni Juridik Ligjvënës nuk e shqyrton Propozimbuxhetin.

(6) Në procedurën për shqyrtimin e Propozimbuxhetit në Trupin punues amë deputeti ka të drejtë për dy replika në kohëzgjatje me nga tre minuta dhe dy kundër-replika në kohëzgjatje me nga një minutë, ndërsa për zbatim jo të drejtë të Rregullores zbatohet në mënyrë adekuate neni 92, paragrafi (5) i kësaj Rregulloreje.

**Neni 190**

(1) Për Propozimbuxhetin, Trupi punues amë mban diskutim të përgjithshëm, i cili zgjat më së shumti katër ditë.

(2) Arsyetim për Propozimbuxhetin jep përfaqësuesi i Qeverisë në kohëzgjatje prej 30 minutash.

(3) Deputeti, gjatë diskutimit të përgjithshëm, mund të flasë disa herë në kohëzgjatje prej 20 minutash, ndërsa koordinatori i grupit të deputetëve gjithsej 30 minuta. Përfaqësuesi i Qeverisë, gjatë diskutimit të përgjithshëm, mund të flasë disa herë, por jo më shumë se 30 minuta gjithsej.

**Neni 191**

(1) Amendament për Propozimbuxhetin mund të parashtrohet më së voni tri ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes së Trupit punues amë. Për parashtrimin e amendamenteve në mënyrë adekuate zbatohet neni 157 i kësaj Rregulloreje.

(2) Diskutimi për amandamentet mbahet në Trupin punues amë dhe zgjat më së shumti gjashtë ditë.

(3) Deputeti, gjatë diskutimit për amendamentin, mund të flasë vetëm një herë në kohëzgjatje prej 10 minutash. Përfaqësuesi i Qeverisë, për pranueshmërinë e amendamentit, mund të flasë vetëm një herë në kohëzgjatje prej pesë minutash.

(4) Parashtruesi i amendamentit mund të japë arsyetim dhe të flasë për amendamentin vetëm një herë në kohëzgjatje prej 15 minutash, e nëse parashtrues të amendamentit janë dy ose më shumë deputetë, vetëm njëri nga parashtruesit mund të japë arsyetim dhe të flasë për amendamentin vetëm një herë në kohëzgjatje prej 15 minutash.

(5) Претресот и гласањето по амандманите се врши соодветно со членот 160 од овој Деловник.

**Член 192**

(1) Ако претресот по амандманите во матичното работно тело не заврши во рокот предвиден во членот 191 став (2) од овој деловник, претресот по останатите амандмани продолжува во наредните два дена (дополнителен рок).

(2) Планот за начинот и времетраењето на претресот по останатите амандмани го подготвува претседателот на матичното работно тело по претходна консултација со координаторите на пратеничките групи. Времето се распределува одделно за секој од останатите амандмани, а го опфаќа и времето за произнесување на претставникот на Владата за прифатливоста на амандманот.

(3) Ако претресот по амандманите не заврши и во дополнителниот рок, матичното работно тело наредниот ден гласа за секој останат амандман поединечно без претрес, најдоцна до 24:00 часот.

(4) По завршувањето на претресот по амандманите матичното работно тело е должно да поднесе извештај до претседателот на Собранието, потпишан од претседателот, односно претседавачот со седницата, кој го доставува до пратениците и до Владата.

**Член 193**

(1) Владата подготвува дополнет предлог на буџетот. Дополнетиот предлог на буџетот претставува нов интегрален текст во кој Владата ги вградила амандманите со кои се согласила и потребните изменувања и дополнувања на предлог на буџетот. Кон дополнетиот предлог на буџетот се доставува и образложение.

(2) На дополнетиот предлог на буџетот амандмани можат да се поднесат најдоцна во рок од три дена пред денот определен за одржување на седницата на Собранието, само на оние делови кои во дополнетиот предлог на буџетот се изменети. Амандмани можат да поднесат секој пратеник, пратеничка група и Владата.

(3) За претресот и гласањето по амандманите на дополнетиот предлог на буџетот соодветно се применуваат членовите 163 и 164 од овој деловник.

(5) Diskutimi dhe votimi për amendamentet zhvillohet në përputhje me nenin 160 të kësaj Rregulloreje.

**Neni 192**

(1) Nëse diskutimi për amendamentet në Trupin punues amë nuk përfundon në afatin e paraparë në nenin 191, paragrafin (2) të kësaj Rregulloreje, diskutimi i amandamenteve tjera vazhdon në dy ditët e ardhshme (afati shtesë).

(2) Plani për mënyrën dhe kohëzgjatjen e diskutimit për amendamentet tjera përgatitet nga kryetari i Trupit punues amë pas konsultimeve paraprake me koordinatorët e grupeve të deputetëve. Koha përcaktohet ndaras për secilin prej amendamenteve të mbetura, dhe gjithashtu përfshin kohën për prononcimin e përfaqësuesit të Qeverisë për pranueshmërinë e amendamentit.

(3) Nëse diskutimi për amandamentet nuk përfundon edhe në afatin shtesë, Trupi punues amë voton ditën e ardhshme për çdo amendament të mbetur veças, pa diskutim, më së voni deri në orën 24:00.

(4) Pas përfundimit të diskutimit për amendamentet, Trupi punues amë është i obliguar t'i paraqesë raport Kryetarit të Kuvendit, të nënshkruar nga kryetari, respektivisht kryesuesi i mbledhjes, i cili ua dërgon deputetëve dhe Qeverisë.

**Neni 193**

(1) Qeveria përgatit Propozimbuxhet të plotësuar. Propozimbuxheti i plotësuar paraqet tekst të ri integral në të cilin Qeveria i ka përfshirë amendamentet me të cilat është pajtuar, dhe ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme të Propozimbuxhetit. Me Propozimbuxhetin e plotësuar dorëzohet edhe arsyetimi.

(2) Për Propozimbuxhetin e plotësuar, amendamente mund të paraqiten më së voni në afat prej tri ditësh para ditës së caktuar për mbajtjen e seancës së Kuvendit, vetëm në ato pjesë të cilat në Propozimbuxhetin e plotësuar janë ndryshuar. Amendamente mund të parashtrojë çdo deputet, grup i deputetëve dhe Qeveria.

(3) Për diskutimin dhe votimin për amendamentet e Propozimbuxhetit të plotësuar, zbatohen në mënyrë adekuate nenet 163 dhe 164 të kësaj Rregulloreje.

**Член 194**

(1) Претресот по предлогот на буџетот, односно по дополнетиот предлог на буџетот на седница на Собрание, се води во втората недела на месец декември и трае најмногу пет дена. Пратеникот во текот на претресот може да говори повеќе пати во траење од вкупно 20 минути, а координатор на пратеничка група вкупно 30 минути. Претставникот на Владата може да говори повеќе пати, но не повеќе од 30 минути вкупно.

(2) Собранието го донесува Буџетот најдоцна до рокот утврден со закон.

**16.2 Постапка за изменување и дополнување на Буџетот**

**Член 195**

(1) Ако предлогот за изменување и дополнување на Буџетот, Владата го поднесе до Собранието најдоцна до 30 јуни, во постапката за негово разгледување и донесување ќе се применуваат одредбите кои се однесуваат на постапката за разгледување и донесување на Буџетот.

(2) Планот за начинот и времетраењето на расправата по предлогот за изменување и дополнување на буџетот го подготвува претседателот на Собранието, по претходна консултација со претседателот на матичното работно тело. Планот подготвен од претседателот на Собранието се усогласува на посебна координација.

**Член 196**

